



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

IEKA

**Pasqyrat Financiare
për periudhën që mbyllet më datën
31 Dhjetor 2023**



INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TE AUTORIZUAR

Pasqyrat Financiare

31 Dhjetor 2023

Përmbajtja:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	6
PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE	7
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	8
1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME.....	9
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL	9
4. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE	11
5. LLOGARI TË ARKËTUESHME	12
6. INVENTARËT	12
7. TË TJERA TË ARKËTUESHME (KUOTA VARIABËL).....	13
8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE	13
9. LLOGARI TË PAGUESHME DHE DETYRIME	14
10. DETYRIME TATIMORE	15
11. TË ARDHURA TË PERIUDHAVE TË ARDHSHME	15
12. NDRYSHIME NË PASURINË NETO	15
13. BURIMET E FONDEVE NGA VEPRIMTARIA KRYESORE	16
14. PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE TË PERSONELIT	16
15. HONORARE TË DREJTIMIT, AUTORITETE, KOMITETE	17
16. SHPENZIME ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA	17
17. BURIMET DHE SHPENZIMET PËR KUALIFIKIMIN EKR & STAZHIERËVE	18
18. BURIMET DHE SHPENZIMET PËR BOTIMET.....	18
19. TEPRICA NETO E BURIMEVE TË VITIT	18
20. DETYRIME TË MUNDSSHME.....	19
21. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT.....	19

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

PËR: ORGANIZATËN JO-FITIMPRURËSE "IEKA"

Opinion me Rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Organizatës Jo-Fitimprurëse Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar "IEKA" të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2023, pasqyrën e aktiviteteve, pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës më datën 31 Dhjetor 2023, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)për OJF-të.

Baza për Opinionin me Rezervë

Siç theksohet në shënimin shpjegues nr. 5 Organizata ka paraqitur në llogari të arkëtueshme nga Anëtarët për kuotën fikse dhe stazhierët në shumën 10,376,535 Lek, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të merrnim siguri të mjaftueshme në lidhje me ekzistencën dhe vlerësimin e kësaj shume në Aktivët e Pozicionit financiar të Organizatës. Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës të cilët kanë teprica të hapura me Organizatën me qëllim saktësimin dhe rakordimin e këtyre tepricave. Procedura e saktësimit dhe rakordimit kërkonte më shumë kohë sesa koha e përcaktuar për kryerjen e auditimit, dhe drejtuesit e Organizatës po punojnë për ta përmbyllur brenda vitit 2024.

Siç theksohet në shënimin shpjegues nr. 7 Organizata ka paraqitur në llogari të arkëtueshme nga Anëtarët për kuotën variabël në shumën 12,806,930 Lek, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të merrnim siguri të mjaftueshme në lidhje me ekzistencën dhe vlerësimin e kësaj shume në aktivët e Pozicionit Financiar të Organizatës. Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës të cilët kanë teprica të hapura me Organizatën me qëllim saktësimin dhe rakordimin e këtyre tepricave. Procedura e saktësimit dhe rakordimit kërkonte më shumë kohë sesa koha e përcaktuar për kryerjen e auditimit, dhe drejtuesit e Organizatës po punojnë për ta përmbyllur brenda vitit 2024.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbyllur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të për OJF-të dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Organizata të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtuesit e Organizatës përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Tiranë, më datë 29 Prill 2024



UHY Elite sh.p.k.
Artan Xhiani, Auditues Ligjor
Tirana - Albania

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 Dhjetor 2023

		Viti i mbyllur 31.12.2023	Viti i mbyllur 31.12.2022
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	84,088,297	83,398,432
Llogari te arkëtueshme	5	10,560,812	10,199,064
Inventarët	6	331,398	354,576
Llogari te arkëtueshme të tjera (kuota variabël)	7	12,806,930	11,175,427
Totali i Aktiveve afatshkurtra (I)		107,787,437	105,127,499
Aktive Afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	31,015,944	31,569,794
Aktive afatgjata jo materiale	8	327,258	-
Totali i Aktiveve Afatgjata (II)		31,343,202	31,569,794
TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		139,130,639	136,697,293
DETYRIMET DHE PASURIA NETO			
Detyrime			
Llogari te pagueshme	9	4,216,636	5,289,876
Detyrime te tjera (kuota variabël)	7	67,620	134,880
Detyrime tatimore	10	675,178	502,864
Detyrime te tjera	11	1,360,000	60,000
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra (I)		6,319,434	5,987,620
Totali i Detyrimeve		6,319,434	5,987,620
AKTIVET NETO	12	132,811,205	130,709,673

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtuesit e shoqatës dhe janë firmosur në datën 29 Prill 2024 nga:

Sektori i Financës

Silda Metani
Silda Metani

Drejtor Ekzekutiv

Doranim Agalliu
Doranim Agalliu

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E BURIMEVE TË FONDEVE

Për periudhën nga 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023

		Viti i mbyllur 31.12.2023	Viti i mbyllur 31.12.2022
BURIMET E FONDEVE			
Burime nga veprimtaritë kryesore			
Kuotat e anëtarësimit të AL, shoqërive, kandidatëve	13	29,986,259	27,398,673
Të ardhura të tjera	13	159,445	130,443
Burimet nga kualifikimi i EKR & stazhierë	17	3,407,092	2,991,805
Burimet nga botimet	18	28,000	-
Totali i burimeve - të ardhurave		33,580,796	30,520,921
PËRDORIMET E FONDEVE			
Përdorimet për veprimtarinë kryesore			
Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit	14	(10,183,418)	(9,702,104)
Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete etj.	15	(6,316,525)	(6,459,363)
Shpenzime administrative dhe të tjera	16	(11,596,944)	(9,373,690)
Shpenzime kualifikimi i EKR & stazhierëve	17	(3,654,776)	(2,655,594)
Shpenzime për botime	18	(23,175)	-
Totali i përdorimit të fondeve		(31,774,838)	(28,190,751)
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore	19	1,805,958	2,330,171
Humbje nga kursi i këmbimi		(10,120)	(29,725)
Të ardhura nga interesat		396,513	711,201
Të ardhura neto financiare		386,393	681,476
Teprica e burimeve nga veprimtaria kryesore	19	2,192,351	3,011,647
Aktivet neto në fillim të vitit		130,709,673	123,141,972
Rritje/(Ulje) e aktiveve neto nga burime të tjera	12	(90,819)	4,556,055
Aktivet neto në fund të vitit		132,811,205	130,709,673

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE

METODA INDIREKTE

Për periudhën nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2023

	Viti i mbyllur 31.12.2023	Viti i mbyllur 31.12.2022
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Përdorime te fondeve për vitin	2,192,351	3,011,646
Rregullime për:		
Amortizimin	1,291,450	1,258,587
Efekti i rregullimit të gabimeve të periudhave të kaluara	(90,819)	4,556,055
Provizione per rreziqe	1,280,000	-
Rritje/rënie në aktivet afatshkurtra	(1,970,074)	(963,192)
Rritje/rënie në detyrimet afatshkurtra	(948,186)	(6,204,271)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit	1,754,722	1,658,825
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	(1,064,857)	(830,014)
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese	(1,064,857)	(830,014)
Rrjedha neto e parasë	689,865	828,811
Mjetet monetare në fillim të vitit	83,398,432	82,569,621
Mjetet monetare në fund të vitit	84,088,297	83,398,432

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione të përgjithshme

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (më poshtë "IEKA" ose "Instituti"), është një shoqatë profesionale që grupon Audituesit Ligjorë dhe Shoqëritë Audituese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. IEKA është krijuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 2 tetor 1995 dhe është regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr. 3573, datë 16 tetor 1998. Instituti ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (të ndryshuar), si dhe me Ligjin për "Organizatat jo-fitimprurëse" dhe me statutin e tij.

Veprimtaria kryesore e Institutit ka për qëllim të sigurojë që profesioni i Audituesit Ligjor vepron në përputhje me interesat e publikut si dhe të mbrojë etikën dhe pavarësinë e anëtarëve të tij. Veprimtaria e Institutit mbikëqyret nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Selia e Institutit ndodhet në "Rruga e Elbasanit", pallati Edil A1 - IT, zyra 321, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes**a. Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Drejtues dhe Asambleja e Përgjithshme për qëllime të raportimit të IEKA si dhe në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF) si dhe në zbatim të udhëzuesit të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për OJF-të, i ndryshuar 2018. Politikat kontabël si më poshtë paraqesin të plotë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

c. Vijueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijueshmërisë. Sipas këtij parimi, IEKA parashikon se veprimtaria e saj do të ketë vijimësi në mënyrë të mjaftueshme që të plotësojë objektivat dhe angazhimet dhe se nuk ka në plan ose nuk do të ketë të nevojshme të ndërpresë aktivitetin e saj në një të ardhme të afërt.

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël**a. Monedha funksionale dhe me të cilën paraqiten pasqyrat**

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lekë (ALL), e cila është monedha raportuese. Informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

b. Njohja e burimeve dhe përdorimit të fondeve

Burimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë njohur mbi bazën e parimit të të drejtave të konstatuara, për kuotën fikse vjetore për çdo anëtar dhe për kuotat variabël të llogaritura si përqindje mbi të ardhurat bruto të realizuara nga secili anëtar. Shuma e kuotës fikse është përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 17 dhjetor 2020 (vendimi nr. 146) i cili zbatohet nga 1 janar 2021. Shuma e kuotës fikse për anëtarët që nuk e ushtrojnë profesionin është e përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve me Vendim nr. 107 të datës 28.06.2014. Përqindjet e kuotës variabël janë përcaktuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të datës 29 qershor 2017 (vendimi nr. 126) i cili zbatohet që nga 1 janar 2018. Masa e kuotës variabël është 0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë dhe 0.3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 mln lekë, të cilat janë respektivisht si më poshtë:

	2023	2022
Kuota fikse për anëtar aktiv	60,000	60,000
Kuota variabël	0.5% dhe 03%	0.5% dhe 03%
Kuota fikse për anëtar pasiv	8,000	8,000

3. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël (vazhdon)

Në burimet e Institutit përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera, siç janë nga kualifikimi i vijueshëm, nga trajnimet, nga botimet, nga regjistrimet anëtarët e rinj si edhe të ardhura nga pajisja me vërtetime. Për secilën kategori të këtyre burimeve të fondeve është paraqitur edhe shuma përkatëse e përdorimeve. Përdorimet e fondeve të njohura në pasqyrat financiare përfshijnë të gjitha pagesat e bëra gjatë vitit dhe shpenzimet e kryera për vitin por që ende nuk janë paguar në fund të vitit.

c. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fund të vitit. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga përkthimi njihen në pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve. Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas kursit të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, ka qënë respektivisht si më poshtë:

	2023	2022
1 USD	103.88	107.05
1 EUR	93.94	114.23

d. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare përfshijnë gjendjen në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në para në banka, të cilat janë për një afat maturimi më pak se një vit. Njohja e interesave të llogaritura mbi depozitat bankare sipas parimit të drejtave të konstatuara.

e. Kërkesa për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar

Kërkesat për t'u arkëtuar dhe detyrimet për t'u paguar në mbyllje të ushtrimit janë paraqitur sipas vlerës së regjistruar në datën e lindjes së tyre me koston historike.

f. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet Afatgjata Materiale (AAM) paraqiten në bilanc me vlerën e tyre bruto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi është përlllogaritur duke përdorur metodën e amortizimit të përsheptuar mbi jetën e dobishme të aktiveve. Për llogaritjen e amortizimit aplikohen këto norma amortizimi mbi vlerën e mbetur si më poshtë:

Kategoria e aktiveve fikse	Normat e Amortizimit	
	2023	2022
Ndërtesa	2%	2%
Mjete transporti	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%
Software e të ngjashme	15%	15%

g. Teprica e burimeve mbi përdorimet

Teprica midis burimeve dhe përdorimeve që krijohet në ushtrimin kontabël pasqyrohet në pasurinë neto të Organizatës.

h. Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Instituti pagan kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e saj, siç është parashikuar në legjislacionin shqiptar. Kontributet, bazuar në pagat bruto, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe sigurimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe sigurimet shëndetësore.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

4. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare në banke dhe arkë, në 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022, janë si më poshtë:

	Në monedh të huaj	Viti i mbyllur 31.12.2023	Në monedh të huaj	Viti i mbyllur 31.12.2022
Paraja në bankë				
Intesa SanPaolo (Lekë)		17,568,977		16,286,583
Intesa SanPaolo (Euro)	0	0	33.24	3,797
Shuma ekuivalente në lekë		17,568,977		16,290,380
Banka Kombëtare Tregtare (Lekë)		17,734,117		22,219,227
Banka Kombëtare Tregtare (Euro)	1,884.51	195,763	2,097.25	239,569
Banka Kombëtare Tregtare-Provimet (Lekë)		594,021		333,604
Shuma ekuivalente në lekë		18,523,901		22,792,400
Raiffeisen Bank (Lekë)		3,692,964		280,070
Raiffeisen Bank (Usd)	2.61	245	62.61	6,702
Shuma ekuivalente në lekë		3,693,209		286,772
Depozita me afat 12 Muaj		44,184,032		43,846,055
Totali në Bankë		83,970,119		83,215,607
Paraja ne arkë				
Paraja në Arkë (Lekë)		83,522		140,503
Paraja në Arkë (Euro)	333.62	34,656	370.50	42,322
Totali në arkë		118,178		182,825
Totali		84,088,297		83,398,432

Mjetet monetare të investuara në depozita, sipas afatit të maturimit 12 muaj, paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur 31.12.2023	Viti i mbyllur 31.12.2022
Depozita me afat 12 muaj	16,323,867	16,227,315
Banka Kombëtare Tregtare	7,500,000	7,500,000
Intesa SanPaolo	20,360,165	20,118,740
Credins Bank	44,184,032	43,846,055
Totali		

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 të ardhurat nga interesi te njohura janë 396,513 lekë prej të cilave 184,277 lekë priten të arkëtohen në të vitin pasardhës, norma efektive e interesit vjetor është 0.7% për BKT, 1.4% për Credins Bank dhe 0.89% për Intesa San Paolo. Depozitat bankare janë në monedhën lekë, me afat maturimi 12 mujore dhe interesi maturohet në fund të afatit.

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë të detajuara si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
AL kuote fikse, pjesore	4,327,891	5,470,698
AL pasive kuota fikse, pjesore	4,504,678	3,426,319
Kërkesa të tjera për t'u arkëtuar	337,000	-
Te drejta ndaj Stazhierëve ndër vite	1,206,966	1,116,966
Interesa aktive te llogaritura	184,277	185,081
	10,560,812	10,199,064

Kuotat fikse të anëtarëve AL janë në vlerën 4,327,891 lekë të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre ndër vite sipas statutit. Gjatë vitit 2023 nga 251 anëtar aktiv gjatë vitit, kanë paguar kuotën fikse, përpjestimore 227 anëtar dhe 24 anëtar nuk e kanë derdhur kuotën fikse të antarësisë në shumën 870,000 lekë.

Kuotat fikse të anëtarëve AL pasivë janë në vlerën 4,504,678 lekë të cilët nuk kanë përmbushur detyrimin e tyre ndër vite sipas statutit. Gjatë vitit 2023 nga 176 anëtare AL të cilët nuk e ushtrojnë profesionin, kanë kryer pagesën e kuotës vjetore apo përpjestimore vetëm 28 anëtar dhe 148 anëtar janë debitor në shumën 1,112,001 lekë.

Kërkesa të tjera për tu arkëtuar përfaqësojnë antarët të cilët janë regjistruar , reregjistruar apo ç'regjistruar si person fizik apo shoqëri dhe gjatë vitit 2023 të drejta për tu arkëtuar ndaj 7 shoqërive të auditimit janë në shumën 225,000 lekë, , si dhe të drejta ndaj avokatit për proceset gjyqësore sipas vendimit të Këshillit të Drejtimit Nr.4 Datë 25.01.2023 në shumën 112,000 lekë .

Të drejtat ndaj stazhiereve janë rritur në shumën 90,000 të cilat nuk janë arkëtuar gjatë vitit 2023, dhe totali i tyre nuk janë arkëtuar ndër vite nga stazhierët e praktikës profesionale.

Interesat aktive të llogaritura në vlerën 184,277 lekë janë të ardhura të cilat janë njohur më 31.12.2023 por që priten të arkëtohen në periudhën pasardhëse dhe i përkasin 3 depozitave bankare.

Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës për të saktësuar detyrimet e anëtarëve dhe për mbledhjen e këtyre detyrimeve sipas përcaktimeve në statutin e Organizatës.

6. Inventarët

Inventarët e botimeve janë të përbërë si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Kodi Etikës	908	910
SNA	12,480	12,480
Guida	63,450	67,950
Revista	52,334	52,334
Udhërrëfyesi	81,404	89,880
SNA mbi raportin e auditorit të pavarur	73,440	83,640
Të tjera	47,382	47,382
Totali	331,398	354,576

Iventarët e librave janë ulur pasi janë shitur disa anëtarëve gjatë vitit me kosto të këtyre botimeve në vlerën 23,178 lekë.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

7. Të tjera të arkëtueshme (kuota variabël)

Të arkëtueshme të tjera përfaqësojnë të drejtat e Institutit ndaj anëtarëve të tij në lidhje me kuotën variabël si më poshtë:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Të drejta për kuotën variabël	12,806,930	11,175,427
Detyrime për kuotën variabël	(67,620)	(134,880)
Pozicioni neto	12,739,310	11,040,547

Këto të drejta lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më pak se misionet e deklaruar.

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2023 janë 12,806,930 Lekë (31 dhjetor 2022: 11,175,427 Lekë) e cila pritet të arkëtohet në vitin pasardhës.

Detyrime të tjera përfaqësojnë detyrimet e Institutit ndaj anëtarëve të tij për kuotën variabël. Këto detyrime lindin kur anëtarët e Institutit kanë paguar më shumë se misionet e deklaruar.

Drejtuesit kanë filluar një proces rakordimi me të gjithë anëtarët e Organizatës për të saktësuar detyrimet e anëtarëve dhe për mbledhjen e këtyre detyrimeve sipas përcaktimeve në statutin e Organizatës.

8. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

Aktive afatgjatë materiale jomateriale në datë 31 dhjetor 2023 dhe 2022 përbëhen nga sa vijon:

	Ndërtesa	Mjete transporti	Pajisje Zyre	Pajisje Informatike	Software e të ngjashme	Total
Kosto më 31 Dhjetor 2022	47,455,444	3,273,550	5,941,344	6,004,048	-	62,674,386
Shtesa				797,780	331,400	1,129,180
Pakësime			(354,182)	(628,496)		(982,678)
Balanca më 31 Dhjetor 2023	47,455,444	3,273,550	5,587,162	6,173,332	331,400	62,820,888
Amortizimi i akumuluar						
Balanca më 31 dhjetor 2022	17,086,350	2,742,647	5,491,033	5,784,560	-	31,104,592
Pakësime			(327,148)	(591,206)		(918,354)
Amortizimi vjetor	949,110	106,181	90,062	141,955	4,142	1,291,449
Balanca më 31 dhjetor 2022	18,035,461	2,848,828	5,253,947	5,335,309	4,142	31,477,687
Vlera Neto Kontabël						
Më 31 Dhjetor 2022	30,369,092	530,903	450,311	219,488	-	31,569,794
Më 31 Dhjetor 2023	29,419,984	424,722	333,215	838,023	327,258	31,343,202

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

9. Llogari të pagueshme dhe detyrime

Llogaritë e pagueshme ne datën 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 përbëhen nga:

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Këshilli i Drejtimit		212,500
Këshilli i Drejtimit mbledhje	12,750	179,350
Komiteti i Edukimit Kualifikimit te Vijueshëm	66,300	43,350
Komiteti i Regjistrimit		53,550
Komiteti i Kontrollit te Brendshëm		255,000
Komiteti i Standardeve Profesionale dhe Etikes	30,600	57,800
Komiteti i Programeve alternative dhe Metodologjisë se Auditimit	20,401	53,551
Komiteti i Kontrollit te Cilësisë		-
Nen-total	130,051	855,101
Detyrime sekretari teknike, ndrysh. R.P,etj	17,189	
Detyrime korrigjues,vëzhgues,shqyrtim dip.	98,005	
Detyrime ndaj punonjësve		400,218
Auditues Ligjor	280,000	
Alpas 2E shpk (Hilton Hotel)		567,933
Detyrime për trajnerët	38,422	481,500
UKT sh.a	2,076	
FSHU sh.a	13,861	
Fatura utilitiare për tu paguar		29,365
Detyrime ndaj të tretëve		70,000
Fond i veçantë për ndihma		300,000
ONE Albania	11,900	
Albania Diving Center	23,577	
Innova Tech	20,000	
Futura Fusion Technology	60,000	
Infosoft Software Developer	331,400	
Bota Shqipëtare	69,800	
Xheko sh.p.k	601,000	
Detyrim për tarifen 7% për BMP	2,519,355	2,585,759
Detyrime te tjera	-	212,500
Nën-totali	4,086,585	4,434,775
Totali	4,216,636	5,289,876

Të gjitha detyrimet më sipër priten të shlyhen në periudhën pasardhëse.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

10. Detyrime tatimore

Llogaritë e pagueshme në datën 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 përbëhen nga:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Shteti tatime taksa (TAP)	191,100	44,961
Shteti tatime taksa Tatim në Burim	227,243	305,223
Sigurime shoqërore	256,835	152,680
	675,178	502,864

Vlera 675,178 lekë përbëhet nga detyrimet ndaj tatim-taksave për muajin dhjetor 2023 të cilat janë shlyer në janar 2023.

11. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera në datën 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 përbëhen nga:

Përshkrimi	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Kuota anëtarësie të marrë në avancë	60,000	60,000
Tarifa Regjistrimi të marrë në avancë	20,000	-
Provizione për rreziqe nga çështje gjyqësore	1,280,000	-
	1,360,000	60,000

Provizione e krijuara gjatë vitit 2023 kanë lidhje me një çështje gjyqësore në proces ku Organizata është e paditur për ndërpreje të një anshme të marrëdhënies së punësimit me një ish punonjës.

12. Ndryshime në pasurinë neto

Pasuria neto e Organizatës paraqitet si më poshtë:

	Të pakufizuara	TOTAL
Teprica në 31.12.2022	130,709,673	123,141,971
Rritja nga aktiviteti ushtrimor	2,192,351	3,011,647
Zbritje nga gabime të tjera të periudhave paraardhëse	(90,819)	4,556,055
Balanca mbyllëse në 31.12.2023	132,811,205	130,709,673

Zbritje të tjera, në shumë 90,819 Lekë vjen si rezultat i disa veprimeve dhe korrigjimeve të gabimeve të viteve të kaluara:

Nr.	Përshkrimi i veprimeve kontabël	Vlera
1	Janë anuluar të drejta nga kuota fikse e njohur gabim në datë 30.12.2021 si e ardhur.	(60,000)
2	Janë rritur të drejtat ndaj kuotës fikse pasive përpjestimore e panjohur në 2020	3,334
3	Janë rritur detyrimet për honorare trajnerë të panjohura në periudhën paraardhëse	(19,153)
4	Janë rritur detyrimet për tatimin në burim , e sistemuar gabim në 2022	(15,000)
	Efekti Neto në Pasurinë neto	(90,819)

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR**Shënime për pasqyrat financiare****31 Dhjetor 2023***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)***13. Burimet e fondeve nga veprimtaria kryesore**

Përfaqësojnë të ardhurat nga kuotat e anëtarësisë, nga regjistrimet e anëtarëve të rinj, shoqërive dhe stazhierëve.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Nga kuota fikse Al-ve	14,445,000	14,653,388
Nga kuota variabël e Al-ve	10,970,268	9,602,101
Nga kuota fikse AL-ve Pasive	1,399,976	1,346,674
Nga kuota e regjistrimit në praktiken profesionale	1,296,015	1,334,010
Nga kuota e përjashtimit nga praktika profesionale	1,150,000	-
Nga kuota e regjistrimit të shoqërive, etj	725,000	462,500
Të ardhura të tjera	159,445	130,443
	30,145,704	27,529,116

Të ardhurat nga kuota fikse Al përfaqësojnë burimet nga kuota fikse prej 60,000 lekë dhe kuota fikse përpjesëtimore për të gjithë anëtarët aktiv.

Të ardhurat nga kuota variabël përfaqësojnë të ardhurat sipas deklarimit të misionëve të AL-ve për vitin 2023 për të cilët deklaruan gjithsej 152 persona fizik kuota variabël e të cilave është në vlerën 5,425,596 lekë dhe nuk deklaruan misionet e tyre 2 anëtar persona fizik gjithashtu gjatë vitit 2023 deklaruan angazhimet e tyre 71 shoqëri auditimi nga 72 shoqëri auditimi aktive kuota variabël e të cilave është në vlerën 5,504,681 lekë misionet të deklaruara dhe të ardhura nga misionet e viteve të periudhave të mëparshme në vlerën 39,991 lekë.

Të ardhurat nga kuota e anëtarëve pasiv përfaqëson burimet nga kuota fikse dhe përpjestiomere gjatë vitit 2023, e cila është 8,000 Lek në vit për çdo anëtar pasiv.

Të ardhurat të tjera përfaqëson të ardhurat nga lëshimi e kërkesat për vërtetime.

14. Pagat dhe sigurimet shoqërore të personelit

Përfaqëson pagat e personelit dhe kontributet për sigurime shoqërore për punonjësit e IEKA. Në fund të vitit 2023 IEKA ka 8 punonjës me kohë të plotë (2022 kishte 6 punonjës me kohë të plotë).

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Pagat e personelit	8,806,247	7,974,003
Kontribute për sigurime shoqërore	1,222,319	1,251,630
Të tjera	154,852	476,471
	10,183,418	9,702,104

Në zërin të tjera përfshihen kontribute të tjera për personelin si honorarë për sekretarinë teknike të KPAP-së për orë jashtë orarit.

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

15. Honorare të Drejtimit, Autoritete, Komitete

Përfaqëson pagesat për honorarë të anëtarëve të institucioneve të IEKA.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Honorare Keshilli i Drejtimit	3,000,000	2,949,818
Honorare Keshilli i Drejtimit Mbledhje	1,108,000	1,264,000
Audituesi i PF	280,000	280,000
Honorare Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	300,000	300,000
Honorare Komiteti Edukimit Kualifikimit të Vijueshëm	726,800	578,000
Honorare Komiteti i Regjistrimit	456,725	471,575
Honorare Komiteti i Kontrollit të Cilësisë	236,000	68,000
Honorare Komiteti i Investigimit e Disiplinës	136,000	56,000
Honorare Komiteti i Standarteve Profesionale e Etikës	68,000	180,000
Honorare Komiteti Programeve Alternative Metod.A	5,000	243,970
Honorare Mbledhje Komisioni Revista		68,000
	6,316,525	6,459,363

16. Shpenzime administrative dhe të tjera

Përfaqësojnë shpenzimet administrative të Organizatës, si më poshtë:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	1,291,450	1,258,587
Kuota regjistrimi në organizma Profesionale	1,485,230	742,156
Udhëtime e dieta	606,834	1,241,977
Telefon, internet, faqe web, postare, taxi	621,981	559,753
Utilitete	170,019	206,055
Kancelari, mirëmbajtje, shërbime	784,289	486,340
Shpenzime për konsulencë ligjore	670,370	1,248,980
Shpenzime për Asamblenë	1,625,302	1,008,605
Shpenzime konferenca 25 Vjetori IEKA	-	798,433
Shërbime bankare	275,183	-
Taksa automjeti, siguracion, kolaudim	67,249	-
Taksa vendore	129,092	-
Certifikatë Elektronike	4,000	-
Vlera kontabël e AAM të çregjistruara	49,944	-
Gjoha, penalitete	421,469	-
Provizione për çështje gjyqësore	1,280,000	-
Shpenzime të tjera	-	942,260
Shpenzime për tarifën 7% për BMP	2,114,532	880,544
	11,596,944	9,373,690

IEKA - INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Shënime për pasqyrat financiare

31 Dhjetor 2023

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lekë)

17. Burimet dhe shpenzimet për kualifikimin EKR & stazhierëve

Përfaqësojnë burimet dhe përdorimin e fondeve për kualifikimin e EKR-ve dhe të stazhierëve.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Burimet e fondeve nga kualifikimi AI	1,509,082	172,000
Burimet e fondeve nga kandidatët	1,898,010	2,819,805
Totali i burimeve	3,407,092	2,991,805
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e AI	(1,369,821)	(714,750)
Përdorimet e fondeve për kualifikimin e kandidatëve	(2,284,955)	(1,940,844)
Totali i përdorimeve	(3,654,776)	(2,655,594)
Teprica	(247,684)	336,211

18. Burimet dhe shpenzimet për botimet

Përfaqësojnë burimet dhe përdorimin e fondeve për botimet.

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Burimet e fondeve nga botimet	28,000	-
Totali i burimeve	28,000	-
Përdorimet e fondeve për botime	(23,175)	-
Totali i përdorimeve	(23,175)	-
Teprica	4,825	-

19. Teprica neto e burimeve të vitit

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2022
Teprica e Burimeve		
Teprica nga aktiviteti	2,048,817	1,964,233
Deficit nga kualifikimet	(247,684)	336,213
Teprica nga botimet	4,825	-
Teprica nga veprimtaria kryesor	1,805,958	2,300,446
Humbje nga kursi i këmbimit	(10,120)	-
Të ardhura financiare	396,513	711,201
Teprica në fund të vitit	2,192,351	3,011,647

20. Detyrime të mundshme

IEKA është e përfshirë në disa çështje gjyqësore në proces si e paditur dhe si paditëse objekti i të cilave ka të bëjë me aktivitetin operacional të organizatës.

Si palë e paditur Organizata është e paditur në pesë procese gjyqësore të ngritura nga anëtarë të Organizatës nga të cilat dy anëtarë janë tërhequr nga padia dhe një e tretë është pushuar nga gjykata e shkallës së parë dhe drejtuesit nuk kanë dijeni nëse pala paditëse ka bërë ankimin në gjykatën e apelit apo jo për pushimin e çështjes.

Dy padi të tjera janë në proces gjykimi ku palët paditëse kërkojnë dëmshpërblim për ndërprerje pa shkak të marrëdhënies së punësimit. Për njërin prej tyre Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranim të pjesshëm të padisë duke i kërkuar Organizatës të dëmshpërblejë ish punonjësën e saj me 8 paga mujore të cilat kapin shumën 1,280,000 Lek. Megjithëse Organizata e ka apeluar këtë vendim, drejtuesit kanë njohur në provizion në shumën 1,280,000lek në pasqyrat financiare të vitit 2023 (shënimi 11). Kurse për çështjen tjetër gjyqësore në proces nuk ka ndonjë zhvillim të qartë se si do jetë ecuria dhe nëse Organizata do të përballet me detyrim të mundshëm apo jo. Për këtë arsye drejtuesit mendojnë se nuk ka nevojë për të krijuar ndonjë provizion shtesë.


Proceset e ngritura nuk kanë ndikuar dhe nuk do të ndikojnë në vijimësinë e aktivitetit.

21. Ngjarje pas datës së raportimit

Pas datës 31.12.2023 nuk ka pasur ngjarje materiale të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë e aktivitetit të organizatës.

Sektori i Financës

Silda Metani

Drejtor Ekzekutiv

Doranin Agalliu